



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 138
Prishtinë, më 12 shtator 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 12, 19 DHE 26 SHTATOR 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup KRASNIQI, ndërsa i ndihmuan nënkryetarët Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti.

Kryetari i hapi punimet e sesionit vjeshtor të Kuvendit dhe procedoi me rendin e ditës të seancës plenare, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Skender Hyseni, Glauk Konjufca, Burim Ramadani, Sevdije Lama, Milivoje Stojanović, Agim Kuleta, Alma Lama, Bekim Haxhiu dhe Teuta Sahatqija, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se cili është motivi i largimit të z. Slavisha Filipović nga detyra e zv/ministrit të FSK-së. A lidhet ky largim me skandalin e spiunazhit lidhur me dërgimin e informacioneve mbi armatimin e FSK-së, në një parti politike në Beograd, nga z. Slavisha Filipović. Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj në lidhje me përmbajtjen e draft-marrëveshjes, e cila po negociohet me shtetin e Katarit për punësim sezonal të punëtorëve nga Kosova.

Ministri Enver Hoxhaj nuk ishte i pranishëm në sallë. Në këtë pyetje u përgjigj ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Nenad Rashiq.

* * *

Në vazhdim, lidhur me rendin e ditës u paraqit deputeti Ali Sadriu, i cili në emër të GP të LDK-së propozoi që pika 4 e propozuar për rendin e ditës - Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012 të shtyhet për njërën nga seancat plenare të radhës. Ai propozimin e arsyetoi me të dhënë se për shqyrtimin e këtij raporti do të duhej që materialeve për këtë pikë t'i bashkëngjiten edhe raportet vjetore të Radiotelevizionit të Kosovës për vitet 2010 dhe 2011.

Më pas, kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve e grupeve parlamentare lidhur me propozimin e deputetit Ali Sadriu.

Për propozimin e lartpërmendur u deklaruan deputetët: Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re; Sasha Milosavleviq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, Milivoje Stojanoviq, në emër të Grupit Parlamentar ZB, si dhe Ismet Beqiri dhe Idriz Vehapi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryetari hodhi në votim propozimin e deputetit Ali Sadriu.

Kuvendi me shumicën e votave e miratoi propozimin e deputetit Ali Sadriu për shtyrjen e shqyrtimit të raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012 në njërën nga seancat e radhës.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i raportit vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012,
5. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012,
6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për mbikëqyrjen e buxhetit të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës,
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
8. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Media,
9. Formimi i Komisionit ad hoc për shqyrtimin e aplikacioneve lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së,
10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së.

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 25 dhe 31 korrik 2013 pa asnjë vërejtje.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012

Kryetari i njoftoi deputetët për raportin e Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media lidhur me raportin mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, raportin me rekomandime e paraqiti Idriz Vehapi, kryetar i këtij komisioni.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e raportit vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jeton Svirca, në emër të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Arsim Bajrami, Vjosa Osmani, Bekim Haxhiu, Salih Morina, Armend Zemaj, Ismet Beqiri dhe ministri Mahir Jagxhilar, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 38,
Kundër ----- 34,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2012.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012

Kryesuesi i njoftoi deputetët se raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit FunkSIONAL e paraqiti dhe e arsyetoi deputeti Idriz Vehapi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim

Kasolli; në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jeton Svirca, në emër të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Muhamet Mustafa, Sadri Ferati, Myzejene Selmani, Hykmete Bajrami dhe Alma Lama, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të punës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 35,
Kundër ----- 29,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi raportin vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2012.

6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për mbikëqyrjen e buxhetit të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës

Deputeti Fatmir Xhelili, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, e paraqiti dhe e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e buxhetit të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës.

Në fund, ai i paraqiti para Kuvendit rekomandimet, të cilat janë paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL dhe i ftoi deputetët për miratimin e raportit me rekomandime.

Diskutimi i deputetit Fatmir Xhelili është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme dhe Siguri për mbikëqyrjen buxhetit të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Vjollca Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re dhe Armend Zemaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme dhe Siguri për mbikëqyrjen buxhetit të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme dhe Siguri për mbikëqyrjen buxhetit të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës.

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Deputetja Flora Brovina, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, tha se si komision kemi bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Kuvendit ia kemi paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej, ajo u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me zbatimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Diskutimi i deputetes Flora Brovina është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Salihe Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Bahri Thaçi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albana Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca, në emër të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Rita Hajzeraj-Beqaj dhe Nijazi Idrizi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 72,
Kundër ----- 1,
Abstënime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision e kemi shqyrtuar raportin e Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së dhe Kuvendit ia kemi paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Diskutimi i deputetit Zenun Pajaziti është dhënë i plotë ne transkript.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Fadil Ismajli, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e paraqiti para deputetëve qëndrimin lidhur me këtë çështje.

Diskutimi i ministrit Fadil Ismajli është dhënë i plotë ne transkript.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Muhamet Mustafa, Hydajet Hyseni, Alma Lama, Halit Krasniqi, Nijazi Idrizi, Shaip Muja dhe kryetari Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve të deputetëve Ismet Beqiri dhe Visar Ymeri, Grupi Parlamentar i LDK-së dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e lëshuan sallën e mbledhjeve.

Kryesuesi më pas konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të hyrë në procedurën e votimit.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa për vazhdimin e punimeve të kësaj mbledhje plenare do të vendosë Kryesia e Kuvendin në takimin e radhës me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 17:45 minuta.

* * *

E enjte, 19 shtator 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 12 shtator

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit HALITI.

Nënkryetari e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 12 shtator 2013. Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 72 deputetë.

Nënkryetari procedoi për pikat, si në vijim:

9. Votimi i raportit të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së

Në fillim, kryesuesi tha se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në mbledhjen e datës 12 shtator 2013. Mirëpo, në mungesë të kuorumit, nuk është proceduar me votimin e këtij raporti.

Para procedimit me votim për këtë pikë të rendit të ditës, deputetët e GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” e dhe ata të GP të AAK-së e lëshuan sallën e mbledhjeve.

Më pas, nënkryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 56 deputetë dhe Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votimin e raportit.

Ai dha pauzë prej 30 minutave dhe i ftoi kryetarët e grupeve parlamentare për konsultim.

* * *

Pas pauzës, për fjalë u paraqit kryetari i GP të AAK-së, Ardian Gjini, i cili theksoi se nëse Koalicioni qeverisës nuk e ka kuorumin, deputetët e Grupit Parlamentar të AAK-së nuk do të qëndrojnë në sallë. Më pas, deputetët e GP të AAK-së e lëshuan sallën e mbledhjeve.

Kryesuesi, në mungesë të kuorunit, e mbylli mbledhjen plenare në orën 12:20 minuta.

E enjte, 26 shtator 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare të filluar më 12 dhe të vazhduar më 19 shtator

10. Formimi i Komisionit ad hoc për shqyrtimin e aplikacioneve lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 5 shtator 2013, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në mbledhjen e sotme plenare t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Në vazhdim, kryetari i ftoi kryetarët e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc.

Kryetarët e grupeve parlamentare i propozuan përfaqësuesit e tyre për anëtarë të Komisionit ad hoc.

Pas këtyre propozimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin e grupeve parlamentare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 68,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaqi nga PDK, kryesuese,
2. Lirije Kajtazi nga LDK, zv/kryesuese,
3. Ganimete Musliu nga PDK, anëtare,
4. Armend Zemaj nga LDK, anëtar,

5. Afrim Kasolli nga “Vetëvendosje”, anëtar,
6. Teuta Haxhiu nga AAK, anëtare,
7. Suzana Novobërdaliu, nga Koalicioni Kosova e Re, anëtare,
8. Jelena Bontiq nga SLS, anëtare,
9. Enis Kervan nga “6+”, anëtar.

II. Komisioni Parlamentar ad hoc, në bazë të nenit 26 pika 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës duhet t’i shqyrtojë dhe t’i përzgjedhë kandidaturat e paraqitura për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

10. Zgjedhja e një (1) anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari propozoi që Kuvendi ta formojë një Komision votues të përbashkët për shqyrtimin e pikave: zgjedhja e një (1) anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media dhe zgjedhja e një anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me arsyetimin e racionalizimit të kohës, ngase procedura e votimit duhet të jetë e fshehtë.

Kryetari kërkoi deklarinimin e deputetëve për propozimin e lartshënuar.

Kuvendi, me shumicë absolute e miratoi propozimin e kryetarit.

Kryetari i ftoi grupet parlamentare që t’i propozojnë anëtarët e Komisionit votues.

Pas propozimeve të grupeve parlamentare, kryetari kërkoi nga Kuvendi miratimin e propozimeve për formimin e Komisionit votues.

Kuvendi me shumicë absolute të votave, mori këtë

VENDIM

Formohet komisioni votues në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaku, nga GP PDK,
2. Afërdita Shaqiri, nga GP LDK,
3. Afrim Kasolli, nga GP VV,
4. Teuta Haxhiu, nga GP PDK,
5. Jeton Svirca, nga GP KKR,
6. Jelena Bontiq, nga GP SLS,
7. Albert Kinolli, nga GP “6+”,
8. Milivoje Stojanoviq, nga GP “ZB”.

Pastaj, kryetari kërkoi nga Komisioni votues që të fillojë me procedurën e votimit, ndërsa i ftoi deputetët një nga një për të votuar.

Në fillim u procedua vetëm me votimin për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media e paraqiti deputetja Xhevahire Izmaku.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 89 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 19 fletëvotime. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për Besim Zeqiri kanë votuar 18 deputetë ndërsa
Për Driton Qeriqi kanë votuar 43 deputetë.

Ajo konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit, asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk i ka fituar votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtar i Komisionit të Pavarur për Media.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Asnjëri nga kandidatët e propozuar: Besim Zeqiri dhe Driton Qeriqi, nuk zgjidhet anëtar i Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.
2. Komisioni i Pavarur për Media duhet të nxjerrë shpallje publike për zgjedhjen e një (1) anëtar i radhët e komunitetit shumicë shqiptar, në pajtim me nenin 11.2 të Ligjit për KPM-në.

Pastaj, u procedua për zgjedhjen e një anëtar i joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin për zgjedhjen e një anëtar i joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës e paraqiti Afërdita Berisha-Shaqiri.

Ajo deklaroi se në votim kanë marrë pjesë 89 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 10 fletëvotime. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Sejdi Rexhepi ka fituar 34 vota,
Driton Balaj ka fituar 13 vota,
Enver Krasniqi nuk ka fituar asnjë votë dhe
Ramë Rexha ka fituar 32 vota.

Ajo konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit për zgjedhjen e një anëtar i joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk i ka fituar votat e nevojshme. Prandaj, duhet të zhvillohet rundi i dytë i votimit për dy kandidatët të cilët kanë fituar më shumë vota: Sejdi Rexhepi dhe Ramë Rexha.

Komisioni votues procedoi me rundin e dytë të votimit për kandidatët Sejdi Rexhepi dhe Ramë Rexha.

Pas zhvillimit të rundit të dytë, në emër të Komisionit votues, raportin për zgjedhjen e një anëtar i joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës e paraqiti deputetja Teuta Haxhiu.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 87 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 12 fletëvotime. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

- Sejdi Rexhepi ka fituar 42 vota dhe
- Ramë Rexha ka fituar 33 vota.

Ajo konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit, asnjëri nga kandidatët as pas rundit të dytë të votimit nuk i ka fituar votat e nevojshme.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Kandidatët e propozuar për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, z. Sejdi Rexhepi, z. Driton Balaj, z. Enver Krasniqi dhe z. Ramë Rexha nuk i morën votat e nevojshme për t'u emëruar anëtar joekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

2. Konkursi publik për zgjedhjen e një (1) anëtari joekzekutiv në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës duhet të përsëritet, në pajtim me nenin 38.2. të Ligjit nr. 03/L- 209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 17:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale